

CEEPUS është Programi i Shkëmbimit të Evropës Qendrore për Studime Universitare. CEEPUS ofron bursat e shkëmbimit për mobilitete, qëndrime afatshkurtra, aktivitete mësimore, shkolla verore dhe programe të tjera afatshkurtra.

Objektivat kryesore janë:

Fokusimi në programet e përbashkëta të doktoratës.

Nxitja e bashkëpunimit në kuadrin e EUSDR.

Vendet anëtare janë : Shqipëria, Austria, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Republika Çeke, Hungaria, Maqedonia, Moldavia, Mali i Zi, Polonia, Rumania, Serbia, Republika Sllovaqe, Sllovenia dhe Kosova.

Ka tre lloje të mobilitetit të studentëve në programin CEEPUS III:

- Mobiliteti për studentët që kanë përfunduar të paktën 2 semestra në institucionin e tyre. Minimumi qëndrimi është tre muaj.
- Mobiliteti afatshkurtë për studentët që punojnë në tezën e tyre (periudhë më e shkurtër se tre muaj).
- Mobilitet afatshkurtër – si pjesëmarrje në shkollat verore deri në gjashtë ditë.

Baza ligjore për CEEPUS është një marrëveshje ndërkombëtare e nënshkruar nga shtetet anëtare dhe e hapur për anëtarësim.

Organi më i lartë i vendimmarrjes CEEPUS është Komiteti i Përbashkët i Ministrave që mbledhet një herë në vit dhe merr të gjitha vendimet strategjike. Koordinimi, vlerësimi, zhvillimi i programit dhe reklamimi janë detyrat kryesore të Zyrës Qendrore CEEPUS. Secili vend ka një zyrë kombëtare CEEPUS përgjegjëse për zbatimin kombëtar.

Kjo marrëveshje është ratifikuar me Ligjin nr.25/2016 “Për ratifikimin e marrëveshjes në lidhje me programin e shkëmbimit të studimeve Universitare në Evropën Qendrore (CEEPUS III)” dhe gjithashtu mbështetet në Udhëzimin nr. 4 datë 16.02.2018 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për zbatimin e programit të shkëmbimit të studimeve Universitare në Evropën Qendrore CEEPUS III në Republikën e Shqipërisë”.

